

**GËRSHETIMI I HISTORISË, LETËRSISË DHE SHKENCËS
NËPËRMJET NJERËZVE, FAKTEVE DHE NGJARJEVE NË
KUJTIMET E STUDIUESIT INJAC ZAMPUTTI**

(Injac Zamputti, *Kujtime, njerëz, fakte, ngjarje*, Albanisches, Institut;
Faik Konica, St. Gallen-Prishtinë, 2020, f.406)

Studiuesi Injac Zamputti, përmes librit “*Kujtime, njerëz, fakte, ngjarje*” sjellë para lexuesit historinë e jetës dhe veprimtarisë së tij, e bashkë me këtë sjellë edhe historinë e Shqipërisë përgjatë tetë dekadave, e cila periudhë për nga rrjedha e ngjarjeve shumë herë ishte vështirë e përballeshme. Botimi këtij libri njëzetedy vjet pas vdekjes së Zamputtit, për nga vlera dhe rëndësia përbën një kontribut me përmasa të gjera.

E para, përmes këtyre kujtimeve del në pah përgatitja intelektuale e shkencore e tij, e cila përfshinte disa fusha ngase gjatë punës tij studiuesin Zamputti e ndeshim si: shkrimtar, gjuhëtar, përkthyes, etnolog, paleograf dhe historian. Nga i tërë opusi i tij i gjerë intelektual e shkencor, Injac Zamputti u dallua sidomos në fushën e historisë qoftë me shkrimet e tij shkencore, ashtu edhe me transkriptimin, përkthimin dhe botimin në gjuhën shqipe të përmbledhjeve me dokumente për historinë e Shqipërisë gjatë shekujve XV-XVIII.

E dyta, në këto kujtime studiuesi Zamputti flet për njerëz të cilët për përgatitjen dhe kontributin në fushën e shkencës dhe albanologjisë ishin dhe mbeten të rrallë, si: Atë Gjergj Fishta, Atë Zef Valentini, Dom Ndre Mjeda etj., ku Zamputti pati fatin të jetë nxënës i tyre, të punojë apo të bashkëpunojë me ta.

E treta, karakteristikë e këtyre kujtimeve janë edhe faktet dhe ngjarjet të cilat me mjaft mjeshtri studiuesi Zamputti na i sjellë në këtë libër, ngjarje të cilat e përcjellën gjatë formësimit të personalitetit të tij intelektual e njerëzor, duke e kalitur dhe edukuar në atë frymë që të jetë në gjendje të përballojë çdo të papritur e vështirësi, me të cilat u përballë gjatë viteve të cilat ai i ka përfshirë në këto kujtime. Për t’ia bërë më të qartë lexuesit sfidat të cilat Injac Zamputti e përcollën gjatë jetës së tij, duke filluar që nga fëmijëria e hershme, këto kujtime janë ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë është:

“Mirazhe - Arritje - Zhgënjime 1910-1944”, dhe pjesa e dytë *“E pakryemja sinfoniskëterrore, 1945-1992”*. Kujtimet e Zamputti fillojnë që nga vitet e hershme të fëmijërisë së tij, të cilat ishin mjaft të rënda. Ishte koha kur Shqipëria dhe vetë Shkodra ku po rritej Zamputti po i përjetonte rënd zhvillimet politike, gjatë rrethimit të saj më 1913. Duke lexuar këto kujtime, lexuesi mund të krijojë një tablo të plotë për fëmijërinë, vështirësitë si pasojë e problemeve ekonomike-shoqërore që solli rrethimi i Shkodrës dhe Lufta e Parë Botërore. Edhe pse fëmijë, ai dhe familja e tij i kishin përjetuar aq rënd pasojat që lanë këto luftëra, sa në këto kujtime mundohet që t’i përshkruan në çdo detaj fëmijërinë dhe rininë e hershme të tij me plotë peripeci, deri në vitin 1928, të cilin autori e quan vit vendimtar për rrugën e jetës së tij, ngase në atëkohë kishte fituar bursën për shkollim në Itali. Pjesë e veçantë e këtyre kujtimeve është sidomos periudha pas përfundimit të shkollimit në Itali dhe kthimi në Shkodër, ku Zamputti kishte filluar punën si mësues në Gjinnazin Saverian.

Duke rrëfyer për punën dhjetëvjeçare në këtë gjinnaz, ai na sjellë disa nga momente më të veçanta nga kjo pjesë e veprimtarisë së tij, e cila siç mund të kuptohet nga këto kujtime ishte mjaft frytdhënëse. Gjatë asaj kohe, Zamputti kishte pasur fatin të bashkëpunojë me Atë Valentinin. Në kuadër të këtij bashkëpunimi ai përmend angazhimin e tij në shoqatën “Leka” dhe detyrat që Atë Valentini ia kishte caktuar në këtë shoqatë. Po ashtu ai tregon edhe për botimin e shkrimeve të tij në revistën e shoqatës që mbante po të njëjtin emër. Shkrimet e tij të para të botuara në revistën “Leka” kryesisht mbanin pseudonimin e tij *Ales*, madje disa nga këto shkrime janë të botuara në kuadër të këtyre kujtimeve. Edhe pse në fillim të karrierës së tij, Zamputti ishte i interesuar për letërsi, megjithatë si rezultat i bashkëpunimit me Atë Valentinin, ai filloi që të shfaqë një interesim për fushën e dokumentacionit historik, siç thekson edhe vetë në këto kujtime: *pa dashur të braktisja synimet letrare, nisa të shijojë bukuritë dhe mësimet që na jep historia*. Autori i këtyre kujtimeve me plotë të drejtë orientimin e tij në fushën e historisë si dhe hyrjen në botën e dokumentacionit e quan histori në vete, e cila përgjatë pesëdhjetë vjetëve do të jetë fusha kryesore e veprimtarisë së tij.

Nga këto kujtime, në veçanti pjesa e dytë, përbën në vete pjesën më të nderë ku shumë studiuese duke përfshirë edhe Injac Zamputtin, u ballafaquan me një realitet tjetër të krijuar që nga viti 1945 deri në fillim të viteve të ‘90-ta kur edhe përfundojnë këto kujtime, periudhë gjatë të cilës studiuesi Zamputti u përball me vuajtje dhe sakrifica, të cilat arriti që më sukses t’i mposht, duke mos rënë në grackat e kohës.

Në pjesën e dytë të këtyre kujtimeve vend të veçantë zënë përshkrimi i pengesave, vështirësive dhe të papriturave me të cilat u përball gjatë viteve 1945-1992, duke filluar nga transferimi në Gjirokastrë, ku u angazhua si mësues i letërsisë në gjimnaz. Angazhimi në këtë detyrë ishte mjaft i rëndë për të, për faktin se për gjatë dy vjetëve sa shërbeu atje vazhdimisht kishte qenë i provokuar dhe i mbikëqyrur, gjë të cilën e kishte përjetuar mjaft rënd. Pas dy vjetëve punë në gjimnazin e Gjirokastrës, Zamputti i caktohet një detyrë e re, ai transferohet në Tiranë ku fillon punën në Institutin e Studimeve Shqiptare. Edhe atje Zamputti përballlet me një sfidë të re, siç e vë edhe vetë në dukje në këto kujtime, kalvari dyvjeçar i Gjirokastrës nuk do të ishte asgjë përball atij të Tiranës.

Përveç këtyre ngjarjeve të cilat shënojnë vetëm fillimin e sfidave më të cilat u përball. Në këto kujtime Zamputti me mjaft përpikëri tregon gjithçka që i ka ngjarë, si: moslejm për të dalë jashtë vendit (Shqipërisë) e sidomos në Itali, ngase atje ndodhej Atë Valentini, dhe se çdo kontakt apo lidhje me të ishte i pamundur dhe me një rrezik shumë të lartë. Mirëpo, kulmi i tërë të këqijave sipas Zamputti, ishte momenti kur iu kishte kërkuar që të spiunonte kolegët e tij, gjë të cilën ai e kishte refuzuar, madje kishte qenë i porositur dhe i kërcënuar që këtë propozim ta mbaj për vete, dhe ashtu ishte detyruar të vepronte. Tmerrin e përjetuar atë natë nuk ia kishte zbuluar as bashkëshortes së tij. Megjithatë këto nuk ishin të këqijat e vetme që i ndodhën Zamputti pas vendosjes në Tiranë. Ai me maturi arriti që t'i tejkalojë duke e ruajtur nivelin e tij prej një shkencëtari të mirëfilltë, i cili për pesëdhjetë vjet me radhë punoi me përkushtim dhe në kushte të jashtëzakonshme, duke na lënë si një thesar të çmuar veprimtarinë e tij shkencore kushtuar kulturës, historisë dhe diplomacisë së popullit shqiptar.

Me kontributin e tij në fushën e historisë në përgjithësi e sidomos në fushën e dokumentacionit, Zamputti i takon merita për transkriptimin, përkthimin dhe botimin e dokumenteve të cilat i referohen historisë së popullit shqiptar gjatë shekujve XV-XVIII, falë punës dhe përkushtimit të tij, ne sot disponojmë përmbledhje më dokumente të cilat u botuan në disa vëllime.

Detyra të cilën Zamputti ia kishte dhënë vetës më përgatitjen e këtyre vëllimeve me dokumente nuk ishte aspak e lehtë për të. Për aq sa na ofrojnë informacione këto kujtime, ishin disa faktorë që e vështirësonin punën e tij në këtë drejtim. Fillimisht do të përmendi faktin se gjatë asaj kohe Zamputti nuk i lejohej që të dilte jashtë Shqipërisë dhe të hulumtonte në arkiva, qoftë në ata italianë apo edhe në Raguzë, prandaj i ndodhur në një situatë të tillë ai u detyrua që për ta përmbushur misionin e tij të

transkriptonte dhe të përkthente dokumente që i sillnin studiuesit e rinj, kryesisht kuadrat të cilët që nga vitet e '60-ta kishte filluar që t'i përgatiste për të bërë kërkime shkencore. Një element tjetër për të cilin studiuesi Zamputti rrëfen në këto kujtime, e që e bënte edhe më të rëndë punën e tij, ishin kushtet e vështira dhe të jashtëzakonshme në të cilat ka punuar për përgatitjen e këtyre dokumenteve për botim.

Mirëpo të gjitha këtyre pengesave dhe vështirësive me të cilat e ballafaqoi jeta, ai arriti që t'u mbijetojë. Këto kujtime të lenë përshtypjen se secila sfidë në jetën e tij e kaliti, e bëri më stoik, ku edhe punoi me mjaft pasion në profesionin të cilin kishte vendosur që të merrej, krahas shumë prirjeve tjera që kishte, si: shkrimtar, gjuhëtar, etnolog, paleograf, por mes këtyre prirjeve ai kishte zgjedhë pikërisht fushën e historisë, ku për kontributin e tij përherë do të mbetet një emër i nderuar dhe respektuar, jo vetëm tek komuniteti shkencor por edhe më gjerë, sepse falë punës së tij është dokumentuar historia e popullit shqiptar gjatë shekujve XV-XVIII, duke dëshmuar dhe vërtetuar se Shqipëria dhe historia e saj gjatë atyre shekujve ishte e lidhur me vendet evropiane të asaj kohe, si: Venedikun, Napolin, Raguzën, Hungarisë.

Botimi i librit "*Kujtime, njerëz, fakte, ngjarje*", i studiuesit Injac Zamputti, është një shembull model për studiuesit se edhe përkundër peripecive me të cilat mund të ballafaqohemi gjatë jetës, nëse i vejmë vetes një mision ashtu siç i kishte venë studiuesi Zamputti, të gjitha do të tejkalohen por vetëm falë punës, angazhimit dhe përkushtimit me dinjitet. Prandaj, të gjitha këto së bashku e bëjnë unike dhe të paharruar punën, veprën dhe emrin e tij.

Teuta SHALA-PELI